



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

URDHËR

Nr. 137 datë 30. 3 . 2017

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 162, DATË 14.07.2014 "PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE TË LUAJTSHME NË PRONËSI PRIVATE PRANË QENDRËS KOMBËTARE TË INVENTARIZIMIT TË PASURIVE KULTURORE",

Referuar shkresës nr.135/3 prot, datë 28.03.2017 të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore "Për një ndryshim të anëtarëve të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit në Urdhërin nr. 162, datë 14.07.2014 "Për Miratimin e Komisionit të Vlerësimit të objekteve të Trashëgimisë Kulturore të Luajtshme në pronësi private pranë Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore" dhe VKM Nr.795, date 26.11.2003 "Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të objekteve të Trashëgimisë Kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedura të vlerësimit të këtyre objekteve", në mbështetje të nenit 9 të Ligjit 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore",

KONSTATOVA

Se, Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Pasurive Kulturore në pronësi private nuk mund të kryejë funksionet e tij pasi një pjesë e anëtarve kanë dalë në pension dhe një pjesë tjetër nuk janë më përfaqësues të institucioneve të përcaktuara sipas VKM Nr.795, datë 26.11.2003 "Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të objekteve të Trashëgimisë Kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedura të vlerësimit të këtyre objekteve"

URDHËROJ:

1. Në pikën 1 të Urdhërit nr. 162, datë 14.07.2014, "Për Miratimin e Komisionit të Vlerësimit të objekteve të Trashëgimisë Kulturore të Luajtshme në pronësi private pranë Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore" përbërjen e Komisionit me ndryshimet si më poshtë"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

- | | | |
|-------------------|---------|---|
| - Silva BRESHANI, | Kryetar | Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore |
| - Ermela BROCI, | Anëtar | Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit |
| - Olsi LASKA | Anëtar | Galeria Kombëtare e Arteve |
| - Agron ISLAMI | Anëtar | Instituti i Monumenteve të Kulturës |
| - Edlria ÇAUSHI | Anëtar | Eksperte e fushës, Universiteti i Tiranës,
Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgmisë Kulturore |
| - Genti VOKOPOLA | Anëtar | Instituti i Monumenteve të Kulturës |
| - Elio HOBDAARI | Anëtar | Instituti i Arkeologjisë |
- Përgjegjësi i Sektorit QKIPK dhe një Specialist QKIPK - anëtarë pa të drejtë vote (sekretari teknike/protokoll)
 - 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë Kulturore për komunikimin e këtij Urdhëri.
 - 3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për zbatimin dhe njoftimin zyrtar të anëtarëve të këtij Urdhëri

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë



MINISTRI

Mirela KUMBARO FURXHI